

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

UDHËZIM
Nr.20, datë 09.05.2008

PËR
VEPRIMTARINË E PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË
(I azhurnuar)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 47, pikat 1 e 2 dhe 50, pika 4, të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

U D H Ë Z O J :

1. Personeli akademik i Institucioneve publike të Arsimit të Lartë (IAL publike), në përbërje të njësive kryesore, fakulteteve dhe instituteve të kërkimit e zhvillimit me njësitë e tyre bazë, departamente e qendra të kërkimit e zhvillimit, quhet personel akademik në IAL publike. Ky personel kryen veprimtari mësimore, kërkimore, si dhe veprimtari të tjera në ndihmë të këtyre proceseve dhe të institucionit, të cilat zhvillohen në raport me misionin e njësisë ku bëjnë pjesë dhe në përmbushje të kërkesave të Ligjit nr.9741, datë 21.05.2007, si dhe të “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë”, duke u organizuar si vijon në këtë udhëzim.

2. Veprimtaritë në të cilat angazhohet personeli akademik në IAL publike, janë:

- a) mësimdhënie;
- b) kërkim, zhvillim e transferim teknologjie;
- c) mbështetje për institucionin.

3. Personeli akademik i IAL publike, kryen veprimtaritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij udhëzimi, në mënyrë të ndërthurrur, me raporte të ndryshme sipas misionit të njësisë dhe përshkrimit të vendit të punës.

4. Mësimdhënia përfshin: zhvillim të leksioneve, seminareve, ushtrimeve, laboratoreve, praktikave mësimore apo profesionale, si dhe veprimtari për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies: përgatitje individuale, zhvillim të kurrikulave, përtëritje të materialeve didaktike dhe hartim të materialeve të reja, modernizim të metodave dhe të procedurave të transmetimit e të kontrollit të dijeve, përgatitje të materialeve didaktike nëpërmjet teknologjive të informacionit e komunikimit dhe përdorimi i këtyre teknologjive në veprimtari të mësimdhënies, provime, kontrole të pjesshme të dijeve, udhëheqje teze diplome të ciklit të parë e të dytë, apo të masterave të nivelit të parë, udhëheqje të projekteve e detyrave, përgatitje shfaqjeje, ekspozite apo gare, konsultime të programuara me studentët, etj.

4.1. Mësimdhënia e normuar vjetore, për personelin akademik me kohë të plotë, konsideron: zhvillimin e leksioneve, seminareve, ushtrimeve, laboratoreve, praktikave mësimore apo profesionale, të përcaktuara këto për çdo disiplinë apo veprimtari formuese në planet mësimore të programeve të studimit.

4.2. Mësimdhënia e normuar vjetore, për personelin akademik me kohë të plotë në fakultete, sipas përcaktimeve në pikën 4.1., të këtij udhëzimi, e shprehur në orë mësimore, është, përkatësisht:

1. Për personelin akademik:

a) Kategoria «Profesorë»;

- me titullin akademik «Profesor» 200 orë mësimore

- me titullin akademik «Profesor i asociuar» 220 orë mësimore

b) Kategoria «Docentë»;

- me titullin akademik «Docent» 300 orë mësimore

- me gradën shkencore «Doktor» 260 orë mësimore

c) Kategoria «Lektorë»; 260 orë mësimore

2. Për autoritetet drejtuese të IAL publike:

a) Rektor / Drejtor Qendre Ndëruniversitare 50/50 orë mësimore

b) Kryetar i Këshillit të Administrimit 120 orë mësimore

c) Zëvendësrektor / Zëvendësdrejtor Qendre Ndëruniversitare 70 /50 orë mësimore

d) Dekan/ Drejtor Instituti 70 /50 orë mësimore

e) Zëvendësdekan / Zëvendësdrejtor Instituti 150/60 orë mësimore

f) Përgjegjës Departamenti / Qendre Kërkimi e Zhvillimi 170/60 orë mësimore

4.3. Për personelin akademik me kohë të plotë në institut dhe qendër të kërkimit e zhvillimit, mësimdhënia e normuar vjetore do të jetë 20-30% e orëve mësimore, përkatësisht, sipas përcaktimeve të pikës 4.2., pika 1., të këtij udhëzimi. Ky personel aktivizohet si rregull në fusha që përputhen me misionin e tyre.

Për nevoja të veçanta të kërkimit, për këtë personel akademik mund të planifikohet mësimdhënie e normuar vjetore më e pakët.

5. Mësimdhënia e normuar vjetore, për personelin akademik me kohë të plotë në fakultete, organizohet me jo më pak se 6 orë mësim në auditor për çdo javë mësimore të vitit akademik.

Mund të përjashtohen nga ky rregull deri 5% e personelit akademik të fakulteteve, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e organizimit të tij. Këto përjashtime vlerësohen rast pas rasti dhe miratohen në mbledhjen e këshillit të fakultetit, mbi bazë të propozimeve të departamenteve.

Nga rregulli përjashtohet personeli akademik i instituteve dhe qendrave të kërkimit e zhvillimit.

6. Ora mësimore është 60 minutëshe.

***7.** Elementet e mësimdhënies së normuar vjetore, të përcaktuara në pikën 4.1 të këtij udhëzimi, konvertohen në orë mësimore si më poshtë:

1 orë leksion në studimet e nivelit të parë 1.5 orë mësimore;

1 orë leksion në MNP, MND dhe DND 2 orë;

1 orë ushtrime/seminar 1.0 orë mësimore;

1 orë laborator 0.8 orë mësimore;

1 orë praktikë mësimore/profesionale 0.5 orë mësimore;

1 orë mësim shoqërimi në Akademinë e Arteve 0.5 orë mësimore.

***(Ndryshuar me Udhëzimin nr.40, dt.08.12.2009)**

***7.1.** Për institucionet e arsimit të lartë që procesin mësimor të ciklit të parë nuk e kanë të organizuar në leksione dhe seminare, 1 (një) orë mësimore konvertohet me koeficientin 1.4.

***7.2.** Për programin e doktoratës, 1 (një) orë mësimore (60 minutëshe) konvertohet me koeficientin 2.5. ***(Shtuar me Udhëzimin nr.25, dt.02.08.2010)**

8. Veprimtaritë për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies, sipas përcaktimeve në pikën 4., të këtij udhëzimi, njehsohen në orë mësimore dhe vlerësohen jashtë mësimdhënies së normuar vjetore, të programuar në pikat 4.2. dhe 4.3., të këtij udhëzimi.

9. Mësimdhënia, që përfshin sipas përcaktimeve në pikën 4., të këtij udhëzimi, mësimdhënien e normuar vjetore dhe veprimtaritë për përgatitjen e mbështetjen e procesit të mësimdhënies, për personelin akademik me kohë të plotë në fakultete, vlerësohet gjithsej 750–1050 orë mësimore, që i korrespondon 50 - 70% e të gjithë fondit të kohës vjetore të punës, sipas përcaktimit në pikën 14 të këtij udhëzimi.

10. Veprimtaritë për kërkim, zhvillim e transferim teknologjie apo veprimtaritë krijuese në IAL publike, përfshijnë:

10.1. Kërkim apo veprimtari krijuese të personelit akademik, nga pjesëmarrje në programe kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, në programe dhe projekte kërkimore që finalizohen me artikuj, monografi, studime e botime shkencore, programe doktorale, raporte progresi e përfundimtare për financuesit e programeve apo projekteve kërkimore, organizim veprimtarish shkencore (konferenca, seminare, kongrese, workshope, etj.) dhe pjesëmarrje në to, elementë kërkimi në se ka në programet e studimit të ciklit të dytë apo mastera të nivelit të dytë, krijimtari, si dhe veprimtari të tjera kërkimi apo krijuese të programuara nga institucioni.

10.2. Veprimtari për zhvillim dhe transferim teknologjie të personelit akademik, apo shërbime të tjera me karakter të ngjashëm, në përputhje me programet dhe strategjinë institucionale, rajonale dhe kombëtare të zhvillimit dhe të transferimit të teknologjive, nëpërmjet konsultave, ekspertizës, përhapjes së njohurive shkencore e teknologjike në mbështetje të bizneseve dhe të ekonomive lokale e kombëtare, trajnimit për transferime të teknologjisë dhe të shkencës, zhvillim për përmirësim të teknologjive, prezantime apo shfaqje veprash artistike, si dhe veprimtari të tjera kërkimi për zhvillim apo krijuese të programuara nga institucioni.

10.3. Veprimtaritë e personelit akademik me kohë të plotë të fakulteteve, të përcaktuara në pikat 10.1. dhe 10.2., të këtij udhëzimi, duhet të planifikohen si rregull jo më pak se 20% e të gjithë fondit të kohës vjetore të punës, respektivisht jo më pak se rreth 300 orë pune vjetore.

10.4. Për personelin akademik me kohë të plotë të instituteve dhe qendrave të kërkimit e zhvillimit, veprimtaritë e përcaktuara në pikat 10.1. dhe 10.2., të këtij udhëzimi, duhet të planifikohen, si rregull, jo më pak se 70% e të gjithë fondit të kohës vjetore të punës, respektivisht rreth 1050 orë pune vjetore.

11. Veprimtari mbështetëse për institucionin në realizimin e misionit të tij, konsiderohen: veprimtaritë për administrimin e njësisive bazë, kryesore dhe të institucionit, apo të programeve të ndryshme të studimit, hartim i programeve të studimit, hartim i rregulloreve apo dokumentacioneve, përgatitje botimesh universitare, pjesëmarrjet në komisione “ad-hoc“, pjesëmarrje në veprimtari të senatit akademik, këshillave, në juri apo redaksi, pjesëmarrje në veprimtari jashtë institucionit kur këto bazohen në marrëveshje, veprimtari promovuese të institucionit, mbështetje për këshillat studentorë, kujdestari për studentët, këshillim karriere, veprimtari të programuara në shërbim të komunitetit lokal apo qëndror, pjesëmarrje në organizata profesionale, si dhe veprimtari të tjera të këtij grupi të përcaktuara në statutin e institucionit.

11.1. Veprimtaritë mbështetëse për institucionin, të përcaktuara në pikën 11, të këtij udhëzimi, për personelin akademik me kohë të plotë, planifikohen 150-300 orë pune, që i korrespondojnë 10-20% e të gjithë fondit të kohës së punës vjetore.

12. Disa nga elementet e veprimtarive për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit mësimor dhe veprimtarive për kërkim, njehsohen në orë mësimore si vijon:

- a) provime / mbrojtje teze diplome 0.4 / 0.5 orë mësimore/student;
- b) udhëheqje teze diplome cikli I / II 15 / 30 orë mësimore/diplomë;
- c) udhëheqje teze diplome master niveli I / II 15 / 30 orë mësimore/diplomë;
- d) (Shfuqizuar me Udhëzimin nr.40, dt.08.12.2009)**
- e) udhëheqje e projekteve të lëndëve 2 orë mësimore/projekt;
- f) udhëheqje e detyrave të lëndëve 0.5 orë mësimore/detyre;
- g) përgatitje shfaqjeje, ekspozite, gare 10-30 orë mësimore/shfaqje;
- h) kontrolle të pjesshme të programuara të dijeve 0.3 orë mësimore/student;
- i) recensë teze diplome cikli I / II 5 / 10 orë mësimore/recensë;
- j) recensë teze diplome master niveli I / II 5 / 10 orë mësimore/recensë;
- k) (Shfuqizuar me Udhëzimin nr.40, dt.08.12.2009)**

***12.1.** Personeli akademik që angazhohet me udhëheqje teze doktorate dhe oponencë teze doktorate konsiderohen ngarkesë jashtë ngarkesës mësimore vjetore. Pagesa do të kryhet sipas akteve nënligjore në fuqi. ***(Shtuar me Udhëzimin nr.40, dt.08.12.2009)**

***12.2.** Pagesa për udhëheqjen e doktoratës është 90 orë mësimore/vit për dy vitet e udhëheqjes së punës kërkimore të pavarur dhe për oponencë teze doktorature është 20 orë mësimore/oponencë. ***(Ndryshuar me Udhëzimin nr.2, dt.07.02.2013)**

13. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, bazuar në propozimet e IAL publike dhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, plotëson listën e veprimtarive të pikës 12 me elementë të tjerë të njehsuar të veprimtarive për kërkim, zhvillim e transferim teknologjie, për përgatitjen e mbështetjen e procesit mësimor dhe për institucionin.

14. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë në IAL publike duhet të përmbushë detyrimet për kohën vjetore të punës me 192 ditë pune (1536 orë), përcaktuar kjo kohë sipas kërkesave në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

15. Organizimi i kohës vjetore të punës për personelin akademik me kohë të plotë në IAL publike bëhet në përputhje me përmbajtjen dhe përcaktimet e bëra në pikat 4, 9, 10 dhe 11 të këtij udhëzimi.

16. Për veprimtaritë e personelit akademik me kohë të plotë në IAL publike mund të bëhen planifikime vjetore në përqindje të ndryshme nga ato të treguara në këtë udhëzim, në mënyrë të argumentuar dhe duke respektuar plotësimin e detyrimit sipas pikës 14, të këtij udhëzimi dhe mësimdhënien e normuar vjetore.

- 17.** Përgjegjësi i njësisë bazë, në konsultim me anëtarët e personelit akademik të saj, miraton në mbledhjen e njësisë programimin e mësimdhënies së normuar vjetore dhe të kohës vjetore të punës, për secilin anëtar të personelit akademik, në përputhje me këtë udhëzim.
- 18.** Organizimi i kohës vjetore të punës dhe programimi i saj në veprimtaritë e ndryshme përbërëse, për çdo anëtar të personelit akademik, formalizohet nëpërmjet një marrëveshjeje vjetore ndërmjet përgjegjësit të njësisë bazë dhe anëtarit të personelit akademik. Një kopje e saj i dërgohet Dekanit/Drejtorit të njësisë kryesore përkatëse.
- 19.** Anëtari i personelit akademik ka të drejtë të apelojë tek dekani/drejtori, lidhur me shpërndarjen e kohës vjetore të punës apo të mësimdhënies së normuar vjetore në veçanti. Vendimi i Dekanit/Drejtorit është përfundimtar.
- 20.** Personeli akademik me kohë të plotë në IAL publike mund të tejkalojë normën vjetore për mësimdhënie deri në masën 30%, pasi të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e kohës vjetore të punës. Tejkalimi i paguar mbi 30% i mësimdhënies së normuar vjetore mund të bëhet vetëm për nevoja të institucionit dhe me miratim nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
- 21.** Për personelin akademik të ftuar në njësitë kryesore të IAL publike mësimdhënia e normuar vjetore duhet të jetë deri në 150 orë mësimore në vit sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij udhëzimi, apo 150 orë punë vjetore për veprimtari të kërkimit apo krijuese, përcaktuar në pikat 10.1. dhe 10.2., të këtij udhëzimi.
- Personeli akademik i ftuar mund të thirret nga një IAL publike kur institucioni nuk i plotëson nevojat për mësimdhënie nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në të.
- 22.** Personeli ndihmës, i cili mbështet mësimdhënien, kërkimin apo krijimin të punësohet me kontratë në përshtatje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.
- 23.** Ky udhëzim do të fillojë të zbatohet duke filluar nga viti akademik 2008-2009.
- 24.** Udhëzimi nr.27, datë 04.10.2004 i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për Ngarkesën Mësimore në Shkollat e Larta”, dhe akte të tjera nënligjore që bien ndesh me këtë udhëzim, shfuqizohen.
- 25.** Ngarkohen të gjitha IAL publike të marrin masat për vënien në zbatim të këtij udhëzimi, sipas përcaktimit në pikën 23 të tij.
- Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Genc POLLO